



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**Nr. 95, Datë 10.12.2008**

**Për**  
**Përcaktimin e hapave të Hetimit të Thelluar në Tregun e**  
**Sigurimit për Produktin TPL**

**Komisioni i Konkurrencës** me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Lush	PERPALI	Zv/Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.12.2008 shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Përcaktimin e hapave të kryerjes së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit për produktin TPL.

**Baza ligjore:** Nenet 24, shkronja d, neni 43/2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

Në mbështetje të Vendimit Nr. 45 datë 19.01.2007 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun e sigurimeve për produktin TPL”;

**V E N D O S I:**

1. Përcaktimin e fazave të kryerjes së hetimit të thelluar për produktin TPL e brendshme si vijon:
  - a) Rishikim dhe rivlerësim i punës së deritanishme të kryer nga Sekretariati për hetimin në tregun e sigurimeve.

- b) Kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve në rast se është e nevojshme;
  - c) Mbledhja e informacioneve të nevojshme;
  - d) Përpunimi i të dhënave dhe vlerësimi i informacionit të mbledhur;
  - e) Organizimin i seancave konsultative me Ministrinë e Financave dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare;
  - f) Përgatitja e nje raporti të ndermjetem dhe diskutimi i tij me Komisionin e Konkurrences ;
  - g) Dorëzimin e raportit perfundimtar;
2. Sekretari i Përgjithshëm të miratojë matricën e veprimeve të hetimit të thelluar sipas hapave të përcaktuar më sipër në këtë vendim brenda datës 22 dhjetor 2008 dhe të njoftojë Komisionin për përmbajtjen e kësaj matrice.
3. Afati i fundit për kryerjen e këtij hetimi është data 15.02.2009.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Lush PERPALI**

**Servete Gruda**

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)  
**Zv/Kryetar**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita Milo (Lati)**

---

**K R Y E T A R**